



Ju dyshoheni për një vepër penale

Si i dyshuar ju ka ndaluar dhe ju ka marrë me vete ndonjë shërbim hetimor siç është policia. Jeni thirrur për t'u marrë në pyetje. Cilat janë të drejtat tuaja dhe çfarë ndodh pasi të merreni në pyetje?

Në këtë fletë informative janë përshkruar të drejtat dhe detyrimet tuaja si edhe mënyra e zhvillimit të procedurës. Lexojeni prandaj me kujdes këtë fletë informative.

Keni pyetje?

A keni pyetje të tjera? Ato mund t'ia drejtoni avokatit tuaj, policisë ose ndonjë shërbimi tjetër hetimor me të cilin keni të bëni. Aty ku në këtë fletëpalosje përdoret termi "polici", mund të nënkuptohet edhe ndonjë shërbim tjetër hetimor.

Vizitoni për më tepër informacione www.juridischloket.nl ose telefononi në numrin 0900 - 8020 (€ 0,25 për minutë).

Në rast se nuk e flisni apo nuk e kuptoni mjaft holandishten

Nuk e flisni dhe nuk e kuptoni mjaft holandishten? Atëherë keni të drejtë për një përkthyes. Kjo është pa pagesë. Ju keni gjithashtu të drejtë që disa dokumente, si për shembull urdhri i paraburgimit tuaj apo fletëthirrja e gjykatës, të përkthehen për ju.

Ju jeni ndaluar nga policia dhe menjëherë ju kanë sjellë në komisariat

Nëse ju ka ndaluar policia si të dyshuar për ndonjë vepër penale, ju do të merreni në pyetje lidhur me atë. Kjo do të thotë se policia ka të drejtë t'ju drejtojë pyetje.

Të drejtat tuaja:

- Ju keni të drejtë që të dini se çfarë vepre penale dyshoheni se keni kryer.
- Nuk e keni të detyrueshme që t'u përgjigjeni pyetjeve (e drejta e heshtjes).
- Ju keni të drejtë që **para** marrjes (së parë) në pyetje të bisedoni në konfidencë me një avokat.
- Ju keni të drejtë që **gjatë** marrjes në pyetje të jetë i pranishëm një avokat që juve t'ju mbrojë. Më poshtë do të lexoni më tepër për këtë.
- Duhet t'i tregoni policisë po qe se nuk kuptoni diçka. Duhet gjithashtu të tregoni nëse e ndieni veten të sëmurë, nëse doni të flisni me një mjek apo keni nevojë urgjente për kujdes mjekësor apo ju nevojiten ilaçe.
- Në rast se (ndihmësi i) prokurori(t) vendos që ju duhet të mbeten në komisariat (të policisë), atëherë ju mund të kërkonti që të njoftohet një palë e tretë (p.sh. anëtar i familjes suaj apo dikush me të cilin banoni) se ju mbajnë të ndaluar. Ka raste kur (ndihmësi i) prokurori(t) mund të vendosë që kjo përkohësisht ende mos të lejohet. Në rast të tillë ai do t'ju njoftojë për këtë.
- Nuk keni shtetësi holandeze? Në atë rast ju mund të kërkonti që konsullata ose ambasada e vendit tuaj të prejardhjes të njoftohet se ju mbajnë të mbyllur.
- Ju keni të drejtë që të njiheni me materialet e çështjes, po qe se ekzistojnë të tilla. Prokurori në disa raste mund të vendosë që kjo përkohësisht mos të lejohet. Në rast të tillë ai do t'ju njoftojë për këtë.

Sa kohë mund t'ju mbajë të mbyllur policia?

- Në varësi të veprës për të cilën dyshoheni në komisarjat mund t'ju mbajnë mbyllur maksimumi 90 orë (3 ditë e 18 orë).
- Në rast se për hetime nevojitet që pas kësaj t'ju mbajnë më gjatë mbyllur, atëherë për këtë vendos gjyqtari. Pyetni avokatin tuaj se çfarë mund të bëni po qe se nuk pajtoheni me ndalimin tuaj apo me vendimin për t'ju mbajtur më gjatë të mbyllur.

E drejta për të pasur avokat

Para se t'ju marrë policia në pyetje ju keni të drejtë që gjysmë ore të bisedoni në konfidencë me një avokat. Kjo bisedë mundet eventua-lish të zgjatet edhe një gjysmë ore më shumë.

- Nëse dyshoheni për një veprë **shumë të rëndë** penale për të cilën rrezikohet dënim prej 12 ose më shumë vjetësh (në mes të tjerave vrasje me paramendim, vrasje) apo nëse në sajë të gjendjes tuaj psikike policia ju konsideron të lëndueshëm, atëherë angazhohet si masë standarde një avokat që të bisedojë me ju. Kjo është pa pagesë.
- Kur ju nuk keni nevojë për të biseduar me një avokat, ju këtë duhet t'ia bëni të qartë avokatit.
- Nëse dyshoheni për një veprë të **rëndë** penale - krime për të cilat mund t'ju burgosin para gjyqimit tuaj (për shembull për vjedhje me thyerje) -, atëherë mund të zgjidhni nëse para marrjes në pyetje dëshironi të bisedoni me një avokat apo jo. Policia kujdeset në atë rast që të angazhohet një avokat. Kjo është pa pagesë.
- Nëse dyshoheni për një veprë **më pak të rëndë** penale atëherë ju mund të zgjidhni nëse do të bisedoni me një avokat apo jo. Atëherë ju duhet që vetë të kontaktoni me një avokat dhe t'i paguani shpenzimet e bisedës me avokatin.

Ju keni të drejtë që edhe gjatë marrjes në pyetje të jetë i pranishëm një avokat që juve t'ju mbrojë. Nëse dyshoheni për një veprë të rëndë penale, avokati për ju është pa pagesë. Nëse dyshoheni për një veprë më pak të rëndë penale, atëherë kostot e avokatit ju ngarkohen juve.

Nëse nuk është e qartë se cili opsion vlen për ju, pyesni:

- nëse në rastin tuaj thirret automatikisht një avokat apo ju vetë mund të zgjidhni për këtë;
- nëse duhet që ju vetë të paguani për ndihmën e avokatit.

Nëse vetë njihni një avokat nga i cili doni të mbroheni, tregojani atëherë policisë këtë. Nëse avokati juaj nuk është i regjistruar te Këshilli për Ndihmë Juridike, shpenzimet e avokatit duhet t'i paguani vetë.

Po qe se për angazhimin e një avokati policia ia përcjell të dhënat tuaja personale Këshillit për Ndihmë Juridike, të dhënat përpunohen në administratën e Këshillit.

- Po qe se ju fillimisht jeni shprehur se nuk doni ndihmë nga një avokat, më vonë ju mund ta ndryshoni vendimin tuaj.
- Nëse jeni shprehur se doni të përdorni të drejtën për t'ju mbrojtur nga një avokat, atëherë policia nuk mund të kryejë marrjen tuaj

në pyetje para se të bisedoni me avokatin tuaj, me përjashtim nëse bëhet fjalë për domosdoshmëri urgjente, si p.sh. situatë e rrezikshme për jetë.

- Kini parasysh se mund të zgjasë pak kohë derisa avokati të vijë në vend. Në parim, avokati duhet të jetë i pranishëm brenda dy orësh nga marrja e njoftimit nga policia.

Jeni ftuar nga policia për t'u marrë në pyetje

Nëse jeni ftuar nga policia për t'u marrë në pyetje sepse dyshoheni për një veprë penale, ju vetë mund të kontaktoni me një avokat, para se të merreni në pyetje. Ai mund t'ju informojë dhe t'ju japë këshilla juridike. Avokati mund të jetë i pranishëm edhe gjatë marrjes në pyetje. Po qe se ju angazhoni një avokat, ju vetë duhet të kujdeseni për shpenzimet.

Ju duhet detyrimisht të identifikoheni, prandaj duhet të merrni një dokument të vlefshëm identiteti me vete (si p.sh. pasaportën apo patentën tuaj të shoferit).

Çfarë mund të bëjë avokati për ju para marrjes në pyetje?

Para se të merreni në pyetje, avokati mund të bëjë këto gjëra për ju:

- ju jep sqarime për veprën penale për të cilën dyshoheni
- ju jep këshilla juridike
- ju tregon se si zhvillohet marrja në pyetje nga policia
- ju tregon se cilat janë të drejtat dhe detyrimet që keni ju gjatë marrjes në pyetje
- kontakton me familjen apo punëdhënësin tuaj që t'i informojë për situatën tuaj (nëse dëshironi këtë).

Policia nuk ju dëgjon kur ju bisedoni me avokatin. Të gjitha ato që ju ia tregoni avokatit janë konfidenciale. Pa pëlqimin tuaj avokati nuk ka të drejtë që të flasë me asnjë njeri për ato që keni folur ju. As me policinë ose me prokurorin.

Çfarë mund të bëjë avokati për ju gjatë marrjes në pyetje?

- Në fillim dhe në fund të marrjes në pyetje avokati mund të bëjë vërejtje apo t'i bëjë pyetje zyrtarit që bën marrjen në pyetje
- Ju ose avokati juaj keni të drejtë që gjatë marrjes në pyetje të kërkoni të ndërpritet marrja në pyetje për t'u këshilluar. Nëse ju kërkoni ndërprerje të shpeshta, zyrtari hetues mund të refuzojë kërkesën.
- Po qe se ju nuk i kuptoni pyetjet ose vërejtjet, po qe se gjatë marrjes në pyetje bëhet presion mbi ju apo në rast se ju për arsye të gjendjes tuaj shëndetësore nuk jeni në gjendje që të vazhdoni marrjen tuaj në pyetje atëherë avokati ka të drejtë që këtë t'ia bëjë me dije zyrtarit që bën marrjen në pyetje.
- Pasi të përfundojë marrja në pyetje ju dhe avokati juaj keni të drejtë që raportin e marrjes në pyetje (ndryshe i quajtur edhe procesverbal) ta shihni dhe të shprehni po qe se në të janë përfshirë gjëra të pasakta.

Çfarë ndodh pas marrjes suaj në pyetje?

Çështja juaj mund të përfundohet në mënyra të ndryshme:

Pushimi i çështjes

Çështja juaj mund të pushohet (me kusht). Kjo do të thotë se ju nuk do të ndiqeni. Por vendimi për pushimin e çështjes mund të parashikojë kushte të cilat ju duhet t'i plotësoni, për shembull, ndalesë kontakti me viktimën dhe/ose mbikëqyrje nga ana e shërbimit për riintegrimin shoqëror me kushte të posaçme. Për shembull, ndalesë kontakti me viktimën dhe/ose mbikëqyrje nga ana e shërbimit i provës me kushte të posaçme. Po nëse ju nuk u përmbaheni atyre kushteve apo kryeni përsëri një vepër penale? Në atë rast ju prapë se prapë mund të akuzoheni për atë çështje. Atëherë ju megjithatë duhet të dilni në gjyq.

Ordonancë penale

Në rast se prokurori mendon se ju jeni fajtor, ai mund t'ju japë një ordonancë penale. Një ordonancë penale për shembull mund të përmbajë një gjobë me para apo dënim me punë. Një ordonancë penale mundet gjithashtu të përmbajë një ndalesë drejtimi të automjetit (në atë rast ju nuk e keni të lejuar të drejtoni automjete) dhe/ose një masë sjelljeje (për shembull një ndalesë kontakti apo kontakt të detyrueshëm me shërbimin e riintegrimit shoqëror).

A doni ta mbyllni menjëherë çështjen tuaj? Atëherë ju gjobën eventuale mund ta paguani menjëherë në komisariat. Këtë mund ta bëni vetëm në rast se ju paraprakisht keni mundur të këshilloheni me një avokat. A paguani menjëherë? Atëherë çështja është mbyllur përfundimisht. Kjo do të thotë se ju nuk mund ta ankimoni më (ta kundërshtoni ordonancën penale).

Po nëse prokurori vendos që t'ju caktojë një ndalesë drejtimi të automjetit apo dënim pune si ordonancë penale? Atëherë ju për këtë më parë do të merreni në pyetje. Para kësaj marrjeje në pyetje ju mund të këshilloheni me një avokat. Ai mund të jetë edhe i pranishëm në marrjen në pyetje.

A doni që avokati të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje? Në atë rast, nëse është e nevojshme, marrja në pyetje do të zhvillohet në një orar tjetër. Para marrjes në pyetje mund të bëhet edhe një lidhje për komunikim me video.

Ujdia

Prokurori mund t'ju propozojë edhe një ujdi. Kjo do të thotë se caktohen disa kushte. Po që se ju u përmbaheni atyre, atëherë i shmangeni ndjekjes penale. Kushtet kryesore janë: pagesa e një shume parash, e një dëmpërblimi për viktimën ose heqje dorë nga mallrat e sekuestruara. Po nëse nuk i plotësoni, apo nuk i plotësoni në kohë ato kushte të ujdisë? Atëherë ju duhet të dilni në gjyq. Edhe ujdinë e propozuar mund ta plotësoni menjëherë. Për shembull nëse nuk keni adresë të njohur banimi ose qëndrimi në Holandë.

Gjyqtari

Çështja juaj mund t'i parashtrohet edhe gjykatës. Në atë rast ju do të merrni një thirrje për të dalë në gjyq. Në të shkruset se për çfarë

vepre penale pandeheni si edhe data, ora dhe vendi ku do të bëhet shqyrtimi i çështjes tuaj penale.

A bëhet shënim në gjendjen gjyqësore apo jo?

A e pranoni ordonancën penale? Apo e pranoni ujdinë që jua propozon prokurori? Atëherë për këtë – ngjashëm me një dënimin që cakton gjyqtari – bëhet një shënim në gjendjen gjyqësore (regjistër gjyqësor). Kjo do të thotë se juve nuk ju lëshohet Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (holandisht: VOG), që mund t'ju nevojitet për vend të ri pune apo për praktikë. Avokati mund t'ju informojë për këtë. Kërkoni nga policia edhe broshurën e posaçme ku jepen sqarime lidhur me pasojat.

Për më shumë informacione vizitoni: www.justis.nl/producten/vog.

Ky është një botim nga:
Ministria e Sigurisë dhe Drejtësisë
Postbus 20301 | 2500 EH | Den Haag

Mars 2017 | 101106

Në sajë të kësaj flete informuese nuk mund të rrjedhë asnjë e drejtë.